



RAPORT VJETOR I KONSULTIMIT PUBLIK PËR VITIN 2023, PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT

1. Përmbledhja ekzekutive

Gjatë vitit 2023, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka miratuar tre akte që kanë pasur detyrimin e konsultimit publik si më poshtë:

Ligji nr. 44/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligji nr. 60/2023 “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë”.

Vendim nr. 542, datë 20.9.2023 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.

Procesi i konsultimit është kryer për dy prej tyre, konkretisht për ligjin nr. 44/2023 dhe vendimin nr. 542 datë 20.9.2023 të Këshillit të Ministrave. Ligji 60/2023 nuk i është nënshtruar procesit të konsultimit publik.

Nga analiza e kryer pas përfundimit të konsultimeve rezultojnë që ka pasur disa sugjerime të përcjella nga publiku për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”. Kemi marrë komente/sugjerime nga shumë palë të interesuara, kryesisht nëpërmjet takimeve të grupit të punës dhe komenteve/sugjerimeve të ardhura me postë. Një pjesë e këtyre komenteve/sugjerimeve janë përfshirë në procesin e vendimmarrjes, duke u integruar në tërësi, në përmbajtjen e projektakteve. Ndërkohë nga monitorimi i regjistrit elektronik të konsultimit publik, rezultojnë se nuk ka pasur komente, përpos komenteve të shumta të grumbulluara në takimet e zgjeruara konsultative, ku pjesëmarrja e aktorëve të interesit ka qenë maksimale. Nxitja e publikut për të rritur pjesëmarrjen në proceset e konsultimit publik mbetet një nga sfidat kryesore të gjithë administratës publike në drejtim të konsolidimit të konsultimit publik, si një hallkë thelbësore në zinxhirin e procesit të hartimit të legjislacionit.

Pra, gjatë vitit 2023, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka realizuar 25% planin e saj të konsultimit publik të akteve të miratuara, objekt i ligjit nr. 146/2014 për “Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, i është nënshtruar një procesi kompleks dhe të zgjeruar konsultimi publik, të realizuar me rreth 90 aktorë të përfshirë dhe grupet e interesit të fushës, në takime të drejtpërdrejta dhe një mase të gjerë qytetarësh nëpërmjet platformës on line të njoftimit dhe konsultimit publik.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i është nënshtruar një procesi kompleks dhe të zgjeruar konsultimi publik me rreth 160 aktorë dhe grupet e interesit të fushës në takime të drejtpërdrejta dhe një mase të gjerë qytetarësh nëpërmjet platformës on line të njoftimit dhe konsultimit publik gjatë vitit 2022, por është miratuar gjatë vitit 2023 me ligjin nr. 44/2023.

Projektligji “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë”, nuk iu nënshtrua procesit të konsultimit publik për shkak të nevojës për miratimin e projektaktit përpara fillimit të vitit akademik 2023-2024 dhe përpara realizimit të provimit të digjitalizuar për pranimin në këtë program.

Për projekt aktet e miratuara është publikuar raporti final për projektaktin e konsultuar dhe miratuar i cili është përgatitur, duke vlerësuar dhe synuar përfshirjen në mënyrë shteruese të kontributit, përmes komenteve dhe rekomandimeve të grupeve të interesit, qytetarëve, të aktorëve të jashtëm jo-qeveritarë, anëtarëve të organeve këshillimore. Gjithashtu, publikimi i raportit final në RENJK, përpara miratimit të aktit në Këshillin e Ministrave, ka si qëllim rritjen e transparencës, nxitjen e publikut për të dhënë mendime, sugjerime e rekomandimeve në mënyrë të vazhdueshme mbi çdo projekt akt apo edhe krijimin e mundësisë efektive dhe efikase për të parë rezultatin e punës së tyre dhe për të reaguar sërish në rast mendimi ndryshe.

Procesi krahasuar me vitin e mëparshëm është përmirësuar, lidhur diversifikimin e mjeteve të përdorura për konsultim, rritjen e aksesit të qytetarëve në konsultim dhe në shkallën e reagimeve të mbledhura. Qytetarët mbeten indiferentë ndaj përcjelljes së komenteve. Kryesisht, sugjerime përcjellin institucionet e interesuara.

Përforcimi i kulturës pjesëmarrëse dhe nxitja e publikut për të rritur përfshirjen në proceset e politik bërjes publik mbetet një nga sfidat kryesore në drejtim të konsolidimit të konsultimit publik.

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Për vitin 2023, me propozimin e MAS janë miratuar 33 akte, nga të cilat 2 ligje dhe 31 vendime të Këshillit të Ministrave.

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Nga aktet e miratuara gjatë vitit 2023 janë konsultuar me publikun dy projektakte, konkretisht ligji nr. 44/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimi nr. 542, datë 20.9.2023 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”. Nuk janë konsultuar 31 akte konkretisht një ligj dhe 30 VKM.

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Nga aktet e miratuara gjatë vitit 2023 dhe që janë konsultuar një projekt akt ka qenë i shoqëruar me raport VNR, konkretisht ligji nr. 44/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, në zbatim të VKM 584/2003 i ndryshuar nuk ka për objekt hartimin e raportit të VNR për këtë projektakt.

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përrjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyt kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Për aktet e programit analitik të vitit 2023 janë përdorur kriteret/përrjashtimet nga konsultimet publike për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Bosnjë-Hercegovinës, Republikës së Kroacisë, Republikës së Çekisë, Hungarisë, Republikës së Moldavisë, Malit të Zi, Republikës së Maqedonisë së Veriut, Republikës së Polonisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë, Republikës së Sllovakisë e Republikës së Sllovenisë, për programin e shkëmbimit të Evropës Qendrore për studimet universitare “CEEPUS IV””, i cili është i përrjashtuar nga detyrimi i konsultimit publik, sipas ligjit nr. 146/2014.

Për sa i përket PKIE dhe dokumenteve strategjike të sektorit, janë konsultuar projekt aktet e miratuara, që kanë pasur detyrim konsultimin publik, 1 projekt akte të planifikuara në PKIE dhe nuk janë konsultuar ato projektakte që nuk e kanë një detyrim të tillë sipas ligjit. Në këtë kuadër nuk janë përdorur kriteret/përrjashtimet nga konsultimet publike për projekt aktet e miratuara, të cilat janë parashikuar në këto dokumente.

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Nga 2 projekt aktet e konsultuara rezulton se njëri prej tyre është Vendim i Këshillit të Ministrave dhe 1 është ligj.

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Në procesin e konsultimit janë përfshirë një numër i gjerë aktorësh, në disa platforma, si RENjK, takime konsultative, e-mail dhe sugjerimet e tyre janë reflektuar si në raportin

individual të konsultimit ashtu edhe në relacionet përkatëse të këtyre akteve që i propozohen për miratim, Këshillit të Ministrave, duke pasqyruar nëse janë pranuar ose jo. Në krahasim me vitin 2023, projekt aktet janë publikuar në sistemin e informacionit të qeverisë (RENjK) si dhe janë realizuar takime duke dhënë informacion të mjaftueshëm lidhur me konsultimin e gjerë me grupet e interesit si dhe janë ruajtur prova të mjaftueshme për reagimet e tyre nëpërmjet raporteve individuale. Në draftet e projekt akteve pasqyrohet një shkallë e mirë e reflektimit të reagimit të palëve të interesuara. Janë organizuar takime konsultative me disa grupe interesi dhe me institucione që preken nga ndryshimet e propozuara.

2.2. Metodat e konsultimit

2.2.1. Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Për të zhvilluar konsultimet publike u përdoren këto metoda:

- I. Publikimi i draftit të projektligjit në Regjistrin Elektronik;
- II. Njoftimi dhe Konsultimi me anë të takimeve konsultative dhe zhvillimi i takimeve publike;
- III. Publikimi i draftit në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;
- IV. Shkresa zyrtare dhe posta elektronike.

Për projekt aktet kemi marrë komente nëpërmjet takimeve të realizuara dhe kërkesa me postë drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, pasi ishin njohur me projekt aktet nëpërmjet faqes zyrtare të MAS. Nga konsultimet publike të kryera më së shumti kemi marrë komente/sugjerime nga takimet e realizuara dhe me postë. Nisur nga ky fakt, këto metoda konsultimi rezultojnë të jetë metoda më efikase.

2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metoda që gjeneroi numrin më të madh të aktorëve të përfshirë në procesin e konsultimit publik janë shkresat zyrtare dhe posta elektronike.

2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Në fazat e hershme të hartimit të projektakteve, grupet e punës realizojnë edhe identifikimin e subjekteve që preken nga zbatimi i projektaktit duke realizuar edhe takime me to për të parë nevojat e tyre.

Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj” është hartuar nga grupi i punës, ku në grupin e punës ka pasur një pjesëmarrje të gjerë duke qenë se përveç grupit qendër janë ngritur edhe nëngrupe pune me tematika të veçanta.

Ligji 44/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në fazat e hershme të hartimit ka trajtuar katër shkresa të përcjella.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Vendimi nr. 542, datë 20.9.2023 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, u publikua për konsultim në faqen e RENJK në datat 10.3.2023-11.4.2023. Po ashtu janë zhvilluar takimet konsultative me grupet e interesit në muajt prill-maj 2023.

Ligji nr. 44/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, u publikua për konsultim në faqen e RENJK në datat 6.7.2022-26.7.2022 dhe 26.10.2022 - 22.11.2022. Gjithashtu, janë zhvilluar takimet konsultative me grupet e interesit në muajt korrik-shtator 2022.

Ligji nr. 60/2023 “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë”, nuk i është nënshtruar procesit të konsultimit publik.

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit publik është përgjithësisht ajo e përcaktuar nga ligji nr. 146/2014 për “Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, 20 ditë pune.

2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Procesi, krahasuar me vitin e mëparshëm është përmirësuar, lidhur me diversifikimin e mjeteve të përdorura për konsultim, për rritjen e aksesit të qytetarëve në konsultim dhe në shkallën e reagimeve të mbledhura, por komentet e marra nuk kanë qenë të shumta, pasi qytetarët mbeten indiferentë ndaj përcjelljes së komenteve. Kryesisht, sugjerime përcjellin institucionet e interesuara.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Në grupin e punës për hartimin e projektakteve nuk ka pasur përfaqësues të jashtëm, jo-qeveritarë.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Nuk ka pasur anëtarë të jashtëm në grupin e punës.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

Për të gjitha projekt aktet e konsultuara rezulton se morën pjesë në total 230 aktorë, nga të cilët dhanë komente 20 aktorë për të gjitha projekt aktet.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Të gjithë kontribuuesit kanë qenë persona juridikë.

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Numri i pjesëmarrësve ka qenë më i ulët dhe përgjithësisht pjesëmarrja nxitet prej takimeve konsultative që organizon institucioni. Përcjellja e sugjerimeve është bërë kryesisht nga organizma që janë të përfshirë në zbatimin e projekt aktit, të ftuar në takime.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Në konsultimin e realizuar për të gjitha projekt aktet janë marrë në total 40 rekomandime. Duke qenë se numri i akteve të konsultuara ka qenë 2 dhe për një projektakt nuk është realizuar procesi i konsultimit publik, esatarja është 13 sugjerime për projekt akt.

2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Për vendimin nr. 542, datë 20.9.2023 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, ka pasur në total 19 komente, nga të cilat 14 janë pranuar plotësisht, 3 janë pranuar pjesërisht dhe 2 komente janë refuzuar.

Ligji nr. 44/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, ka pasur në total 21 komente, nga të cilat 3 janë pranuar plotësisht, 2 janë pranuar pjesërisht dhe 16 komente janë refuzuar.

Ligji nr. 60/2023 “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë”, nuk i është nënshtruar procesit të konsultimit publik.

2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Në krahasim me vitin 2023 ka patur numër më të ulët sugjerimesh pavarësisht se Ministria e Arsimit dhe Sportit ka realizuar disa takime konsultative për të përfshirë një numër të gjerë të grupeve të interesit.

2.5.4. Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Me raport VNR është shoqëruar vetëm ligji nr. 44/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili nuk është ndryshuar në përfundim të procesit të konsultimit publik. VKM nr. 542/2023 nuk ka pasur si detyrim hartimin e raportit të VNR-së.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Ministria e Arsimit dhe Sportit ka publikuar dy raporte individuale të konsultimit publik, përkatësisht për vendimin nr. 542, datë 20.9.2023, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj” dhe ligjin 44/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nuk u publikuan raporte individuale të konsultimit publik për ligj 60/2023 "Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë”, duke qenë se projektakti nuk iu nënshtrua konsultimit publik.

2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Për sa i përket ligjit 60/2023 "Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë”, nuk u publikua raport i konsultimit publik, pasi për shkak të nevojës për miratimin e tij përpara vitit akademik 2023-2024 projekti u propozua për miratim me procedurë të përshpejtuar, pa u publikuar në RENJK.

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik

Si konkluzion konstatohet se procesi i konsultimit publik referuar të gjitha akteve është mesatarisht 5 pikë nga 8 të mundshme, kjo për shkak të mos konsultimit të një projektakti.

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen *(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

Sfida kryesore mbetet nxitja e publikut për të rritur pjesëmarrjen në proceset e konsultimit publik. Për të bërë të mundur rritjen e pjesëmarrjes së publikut, nëpërmjet dhënies së mendimeve/sugjerimeve kërkohet angazhimi i të gjitha institucioneve shtetërore, të përfshira në procesin e konsultimit.

Mendojmë se për të përmirësuar procesin e konsultimit publik dhe për të siguruar një përfshirje sa më të madhe të publikut në këtë proces, është e nevojshme dhe zhvillimi i trajnimeve mbi procesin e konsultimit publik për të gjithë nëpunësit që merren me hartim legjislativ.

Për sa më lart, me qëllim përmirësimin e cilësisë së procesit, sugjerohet ndërgjegjësimi edhe më tepër, përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik, në përshtatje me zhvillimet më të fundit të mjeteve të informacionit.